



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.17

2005

25 mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9342 datë 10.2.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito centrale (MCC S.P.A), për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmente rrugore Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë”	649
Ligj nr.9343 datë 10.2.2005	Për disa ndryshime në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”	659
Ligj nr.9344 datë 17.2.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”	660
Ligj nr.9345 datë 17.2.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Polonisë për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar”	661

Ligj nr.9346 datë 17.2.2005	Për disa shtesa në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, i ndryshuar	665
Udhëzim i MF dhe MBU nr.1, datë 14.12.2004	Për një shtesë në udhëzimin nr.1, datë 6.2.2003 “Për disa shtesa në udhëzimin nr.1, datë 10.11.1998 “Për përdorimin e të ardhurave””.....	666
Udhëzim i MF dhe MBU nr.1, datë 14.12.2004	Për kriteret e përcaktimit të tarifës për dhënien e lejes së përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit	667
Vendim i ERE nr.9, datë 9.3.2005	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2005 për operatorët e licencuar.....	670
Vendim i ERE nr.14, datë 11.3.2005	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “Spahiu-Gjanç” sh.p.k.....	671
Vendim i ERE nr.15, datë 11.3. 2005	Për kompensimin e konsumatorëve ndaj të cilëve nuk janë zbatuar vendimet e ERE-s për vlerat e faturimit aforfe.....	671
Vendim i KKRT nr.322, datë 7.3.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “Tv Calvin”.....	672
Vendim i KKRT nr.323, datë 7.3.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “Nesër Tv”.....	672
Vendim i KKRT nr.324, datë 7.3.2005	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik vendor privat “Radio Rusvelt”.....	673
Vendim i KKRT nr.326, datë 7.3.2005	Për heqjen e licencës së televizionit kabllor “CNA”.....	674
	Shpallje kërkesë për shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve preken nga projekti për instalimin e dritave të uljes në aeroportin “Nënë Tereza”.....	676
	Shpallje kërkesë për shpronësim me interes publik të pasurisë së paluajtshme të tipit “Shtëpi banimi”, e cila rrezikohet nga “linja e tensionit të lartë 400 kv Elbasan-Kufi”.....	677

LIGJ
Nr. 9342, datë 10.2.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITOCENTRALE
(MCC S.P.A), PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT
RRUGOR LUSHNJË-FIER DHE MBIKËQYRJEN E PUNIMEVE PËR DY SEGMENTE
RRUGORE, LUSHNJË-FIER DHE FIER-VLORË”**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocreditocentrale (MCC S.p.A), për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmente rrugore, Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4495, datë 28.2.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MCC SPA
24 350 000, 00 EURO

**“NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LUSHNJË-FIER DHE SUPERVIZIONI I PUNIMEVE
PËR DY SEGMENTET E VAZHDUESHME LUSHNJË-FIER E FIER -VLORË”**

Marrëveshje financiare, sipas nenit 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i quajtur “Huamarrësi”), përfaqësuar nga Ministria e Financave nëpërmjet Ministrit të Financave z.Arben Malaj, nga njëra anë, dhe

MCC S.p.A, (shoqëri aksionare sh.a.), Grupi Bankar Kapitalia, shoqëri e listuar në regjistrin e bankave me një kapital prej 475 138 635 euro (katërqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e njëqind e tridhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë), me qendër në Via Piemonte 51-00187, Romë, Regjistri i Ndërmarrjeve Romë, TVSH nr.00915101000, kodi fiskal nr.00594040586 (në vijim i quajtur “MCC”) si menaxhues i fondit të ngritur, sipas nenit 6 të ligjit italian nr.49, datë 26 shkurt 1987, përfaqësuar nga Dr.Massimo Pecorari dhe ing. Francesco Anania, nga ana tjetër.

Duke qenë se

Qeveria e Republikës Italiane dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar më 25 shkurt 2004 një marrëveshje programi që ka të bëjë me realizimin e programit “Ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe supervizioni i punimeve për dy segmentet e vazhdueshme Lushnjë-Fier e Fier-Vlorë”,

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Qeverisë së Republikës të Italisë me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me dekret nr.53 870, datë 1.6.2004 ka autorizuar MCC-në, për t'i dhënë Shqipërisë një kredi financiare prej 24 350 000, 00 euro (njëzet e katër milionë e treqind e pesëdhjetë mijë), përveç të tjerave, dhe me kushtet e mëposhtme:

- shlyerja: në 42 (dyzet e dy) kuota të barabarta e të njëpasnjëshme gjashtëmujore, ku të parës i skadon afati 210 (dyqind e dhjetë) muaj, pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare;

- norma e interesit: nominale vjetore, 0,10 % (zero presje dhjetë për qind), e pagueshme çdo gjashtëmujor pasues, duke u nisur nga çdo përdorim i shumës;

qëllimi i kredisë është: “Ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe supervizioni i punimeve për dy segmentet e vazhdueshme Lushnjë-Fier e Fier-Vlorë”.

Për sa u përshtrua,

konsiderohet pjesë përbërëse dhe thelbësore e kësaj Marrëveshjeje financiare bashkë me shtojcat bashkëlidhur, Palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Përkufizime

Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje financiare dhe shtojcave përkatëse bashkëlidhur, do t'u bëhet referencë në mënyrë të herëpashershme shprehjeve të mëposhtme me kuptimet e dhëna atyre:

- “Banka Vepruese italiane”: do të thotë banka, me filial në Romë, e caktuar nga Huamarrësi, në përputhje me çka parashikohet në shtojcat A dhe C bashkëngjitur, dhe ku pranë së cilës do të hapet në emër të vetë Huamarrësit, një llogari rrjedhëse (në vijim e quajtur “Llogari e jashtme”) për kreditimin e fondeve të nevojshme për kryerjen e pagesave të parashikuara në kontratat tregtare;

- “Banka Vepruese në Shqipëri”: do të thotë një bankë e nivelit të dytë në Shqipëri, që Huamarrësi, e cakton si bankë vepruese të tij për zbatimin e Marrëveshjes financiare në fjalë;

- “Kontratat tregtare” do të thotë kontrata/at tregtare që ka/kanë të bëjnë me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve nga ana e eksportuesve italianë tek importuesit shqiptarë, në lidhje me realizimin e programit;

- “Autoritetet kompetente italiane”: do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme (organet kompetente të bashkëpunimit: Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim, Komiteti Drejtues etj.) dhe/ose Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe/ose institucione të tjera italiane kompetente me ligj;

- “Marrëveshje financiare”: do të thotë Marrëveshja financiare në fjalë. Kushtet dhe shtojcat që janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të saj;

- “Kredi financiare”: do të thotë financimi që MCC-ja, me autorizimin e marrë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, jep sipas afateve dhe kushteve të treguara në hyrje dhe në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje financiare;

- “Deklarim i borxhit”: do të thotë deklarimi, që parashikohet në nenin 9, me të cilin Huamarrësi i detyrohet MCC-së, për shlyerjen e kuotave kapitale dhe interesat, që të dyja detyrime në lidhje me kredinë financiare;

- “Dokumentacioni kontraktual”: do të thotë dokumentacioni i parashikuar në kontratat tregtare, lidhur me mënyrat e pagesës (p.sh. fatura, lading bill, packing list, ecuri punimesh etj...);

- “Periudha Grace”: do të thotë periudha që fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare dhe përfundon 17 (shtatëmbëdhjetë)vjet pas kësaj date, siç tregohet në hyrje;

- “Njësia e zbatimit të projektit”: do të thotë njësia teknike e ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Shqipëri, që do të kujdeset për zbatimin e programit;

- “Programi” do të thotë programi i rënë dakord ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i financuar pjesërisht nga kredia financiare dhe i finalizuar në realizimin e projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë — Fier dhe supervizioni i punimeve për dy segmentet e vazhdueshme Lushnjë-Fier e Fier-Vlorë”.

Neni 2 **Kredia financiare**

2.1. MCC i jep Huamarrësit, i cili pranon kredinë financiare me vlerë maksimale prej 24 350 000,00 (njëzet e katër milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) euro.

2.2. Kjo kredi financiare është e destinuar për financimin e kontratave tregtare që kanë të bëjnë me realizimin e programit.

2.3. Kontratat tregtare në lidhje me programin, të përmendura në nenin 2.2 do të gjykojnë sipas dispozitave të përfshira në “Manualin e Procedurave” (i miratuar nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002), lidhur me: sipërmarrjen e shërbimeve, të pajisjeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta).

2.4. Përqindja e dhënë për shpenzimet në vend dhe/ose në vendet e tjera në zhvillim, është e barabartë me 50 % (pesëdhjetë për qind) të vlerës totale të kredisë financiare; nga autoritetet kompetente italiane mund të autorizohen shtesa të tjera të mundshme.

2.5. Është e përshtatshme që Banka Vepruese italiane në lidhje me kredinë financiare, të jetë filiali i Romës i San Paolo IMI.

2.6. Është e përshtatshme që Banka Vepruese në Shqipëri në lidhje me kredinë financiare, të jetë Banka Amerikane e Shqipërisë.

2.7. Kredia financiare do të jetë e disponueshme dhe e përdorshme në kohën, mënyrat dhe kushtet e parashikuara nga Marrëveshja financiare në fjalë, përveçse, kur parashikohet ndryshe me ligje të ndryshme, rregullore dhe/ose dispozita të nxjerra nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 3 **Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje financiare**

3.1. Në funksion të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare, MCC-ja duhet të marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme:

i) Aktin e emërimit, të lëshuar nga organi kompetent i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që dëshmon kompetencën e Huamarrësit për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, këtë Marrëveshje financiare dhe për të marrë përsipër angazhimet që rrjedhin prej saj, sipas dispozitave ligjore, rregulluese dhe administrative, që janë në fuqi në Shqipëri.

ii) Aktin e emërimit, lëshuar nga Huamarrësi, që përcakton personin/at e/të autorizuar sipas rregullave, për të firmosur Marrëveshjen financiare, deklarin e borxhit, sipas formës në shtojcën E, që përmendet në nenin 9 vijues dhe dokumentet e tjera të parashikuara në këtë Marrëveshje financiare në shtojcat A, B dhe C. Një akt i tillë do të specifikojë emrin dhe cilësinë e personave dhe do të shoqërohet nga depozitimet e përditësuara të firmave, Huamarrësi do t’ia dërgojë aktin, depozitimet e firmave dhe ndonjë ndryshim të mundshëm të mëtejshëm, edhe Bankës Vepruese italiane.

iii) Kopjen e mandatit të dhënë Bankës Vepruese italiane, për hapjen e llogarisë së jashtme në emër të Huamarrësit e për përdorimin e fondeve të kredituara në të, ekskluzivisht dhe vetëm për kryerjen e pagesave të treguara nga vetë Huamarrësi dhe sipas mënyrës së përcaktuar nga vetë ai. Ky mandat duhet të hartohet në përputhje me shtojcën A, dhe duhet të pranohet shprehimisht nga Banka Vepruese italiane, e cila duhet t’ia konfirmojë këtë me shkrim Huamarrësit dhe MCC-së (kopje).

3.2. MCC, menjëherë sapo të ketë marrë dokumentacionin e lartpërmendur dhe të ketë kryer verifikimin mbi përputhshmërinë e plotë të tij, ia komunikon Huamarrësit, Bankës Vepruese në Shqipëri dhe Bankës Vepruese italiane, me një letër ose faks, duke ua konfirmuar më pas me letër, datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Afatet e përdorimit të kredisë financiare

4.1. Afati i përdorimit të kredisë financiare është 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare. Ky afat mund të zgjatet nga ana e MCC-së, përveçse, kur i komunikohet ndryshe nga Huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane, të paktën një muaj para skadimit të afatit.

4.2. Në rast se afati i përdorimit ka skaduar dhe nuk mund të shtyhet, MCC, pas marrjes së mendimit të autoriteteve kompetente italiane, i komunikon Huamarrësit dhe Bankës Vepruese në Shqipëri, anulimin e angazhimit lidhur me fondet e papërdorura.

Neni 5

Kushtet e përdorimit të kredisë financiare

5.1. Kredia financiare do të jetë e përdorshme nga Huamarrësi pas plotësimit të kushteve të mëposhtme:

i) marrja nga ana e MCC-së e miratimit të dhënë prej autoriteteve kompetente italiane, që ka të bëjë me vendosjen e kontratave tregtare mbi kredinë financiare;

ii) rezultati pozitiv i hetimit të MCC-së, mbi kompetencën e përcaktuar në nenin vijues 5.2(1);

iii) marrja, nga ana e MCC-së, e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve dhe letrës me udhëzimet për Bankën Vepruese italiane, siç parashikohet në nenet vijuese 6.1 dhe 6.2.

5.2. Në vijim të marrjes prej MCC-së së autorizimit të përmendur në nenin pararendës 5.1(1), MCC do të veprojë njëkohësisht për:

i) Fillimin e hetimit sipas kompetencës, që parashikon kryerjen e kontrolleve sipas dispozitave të autoriteteve kompetente italiane, lidhur me eksportuesit italianë dhe subjekte/shoqëri italiane/ të përfshira në ndërmarrje të mundshme vendase, për përputhshmërinë e kontratave tregtare me karakteristikat e kredisë financiare, si dhe për plotësimin e detajit të kostove të kontratës tregtare, me qëllim verifikimit të parashikuara në nenin 7.4 vijues.

ii) Dërgimin e një njoftimi Huamarrësit dhe Bankës Vepruese në Shqipëri rreth marrjes së miratimit sipas nenit 5.1(i), dhe t'i kërkojë Bankës Vepruese në Shqipëri, përcjelljen e kërkesës mbi vënien në dispozicion të fondeve dhe të letrës me udhëzimet për Bankën Vepruese italiane, siç parashikohet në nenet vijuese 6.1 dhe 6.2.

5.3. Rezultati pozitiv i hetimit të MCC-së do t'i hapë rrugë përfshirjes së kontratave tregtare në kredinë financiare. Kontratat tregtare të përfshira do të financohen vetëm pas plotësimit të kushtit të pikës 5.1 (iii).

5.4. MCC do të informojë Huamarrësin, Bankën Vepruese, Bankën Vepruese në Shqipëri, NJZP dhe eksportuesin italian, rreth përfshirjes dhe financueshmërisë së kontratave tregtare.

Neni 6

Kërkesa për kreditimin e fondeve

6.1. Në vijim të komunikimit të MCC-së mbi marrjen e miratimit sipas nenit 5.1 (i), Banka Vepruese në Shqipëri do t'i drejtojë MCC-së një letër kërkesë për vënien në dispozicion të fondeve të nevojshme për përballimin e pagesave të parashikuara në secilën kontratë furnizimi. Me këtë kërkesë, e cila do të përpilohet në përputhje me shtojcën B, Huamarrësi njej financueshmërinë dhe rregullshmërinë e kontratave tregtare dhe angazhohet t'i shlyejë MCC-së, vlerën përkatëse që do të livrohët.

6.2. Banka Vepruese në Shqipëri, përveç kësaj, do t'i dërgojë njëkohësisht Bankës Vepruese italiane dhe një kopje MCC-së, përkatësisht për çdo kontratë tregtare të lartpërmendur, një letër udhëzimesh të përpiluar sipas shtojcës C, e cila duhet të pranohet shprehimisht nga Banka Vepruese italiane, në një komunikim me shkrim, drejtuar Huamarrësit, vetë Bankës në Shqipëri dhe MCC-së (kopje).

6.3. Letra e kërkesës dhe ajo e udhëzimeve të parashikuara në nenet 6.1 e 6.2, duhet të dërgohen në kohë, por gjithsesi jo më larg se 6 (gjashtë)muaj nga data e komunikimit të MCC-së, parashikuar në nenin 5.2 (ii). Nëse kalohet ky afat, MCC do të vlerësojë, pas dëgjimit të mendimit të autoriteteve kompetente italiane, anulimin e mundshëm të kontratave tregtare të vendosura mbi kredinë financiare

6.4. Në bazë të udhëzimeve të marra nga Banka Vepruese në Shqipëri sipas nenit 6.2 Banka Vepruese italiane do t'i kërkojë herë pas here MCC-së, kreditimin në llogarinë e jashtme, të fondeve të nevojshme, për kryerjen e pagesa të parashikuara në kontratat tregtare përkatëse, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 7 vijues. Banka Vepruese italiane do të hartojë kërkesat për kreditim, në përputhje me shtojcën D dhe do t'i transmetojë një kopje Huamarrësit dhe Bankës Vepruese në Shqipëri.

Neni 7

Mënyrat e kreditimit të fondeve

7.1. Duke iu përmbajtur afatit të përdorimit të kredisë financiare, parashikuar me nenin 4.1, çdo kërkesë e pjeshme ose e plotë e kreditimit të parashikuar në nenin 6.4, duhet t'i dërgohet MCC-së brenda, por jo më shumë se 24 muaj nga komunikimi, sipas nenit 5.4 rreth financueshmërisë së kontratave tregtare, ose brenda dhe jo më shumë se afati më i fundit, që duhet të jetë i parashikuar në këto kontrata tregtare. Pas kalimit të këtij afati, MCC, pasi të ketë dëgjuar mendimin e autoriteteve kompetente italiane, do të vlerësojë anulimin e mundshëm të shumave të papërdorura lidhur me secilën kontratë tregtare.

7.2. Secila prej kërkesave të kreditimit sipas nenit 6.4, duhet të paraqitet për çdo pagesë që do të kryhet, sipas mënyrave të parashikuara në secilën kontratë tregtare, pas paraqitjes së dokumentacionit kontraktual.

7.3. Dokumentacioni kontraktual do t'i dorëzohet Bankës Vepruese italiane nga eksportuesit italianë dhe do t'i përcillet në origjinal nga po kjo bankë, Bankës Vepruese në Shqipëri dhe NJZP-së, si dhe MCC-së në kopje të njehsuar me origjinalin.

7.4. NJZP duhet që brenda 15 ditëve nga data e dërgimit të dokumentacionit të mësipërm kontraktual nga ana e Bankës Vepruese italiane, të dërgojë komunikim zyrtar me faks rreth përputhshmërisë (ose jo) të furnizimit të marrë me çka është parashikuar në dokumentacionin kontraktual, vetë Bankën Vepruese italiane dhe Bankën Vepruese në Shqipëri për dijeni.

7.5. Në rast se NJZP nuk vepron në afatet dhe mënyrat e treguara më lart, Banka Vepruese italiane do të quajë automatikisht të mirëqenë përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktual me furnizimin e do t'i dërgojë MCC-së, dhe për dijeni Bankës Vepruese në Shqipëri, kërkesën për kreditim, të hartuar në përputhje me shtojcën D.

7.6. Në vijim të marrjes së çdonjërës kërkesë për kreditim, MCC do të procedojë me verifikimin e dokumentacionit kontraktual. Ky verifikim lidhet me përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktual të mësipërm me kontratat përkatëse të furnizimit.

7.7. MCC do të ekzekutojë kërkesat e mësipërme për kreditim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së tyre.

7.8. Në varësi të daljes së rezultatit pozitiv nga verifikimi, sipas nenit 7.6, MCC do t'i japë Bankës Vepruese italiane, udhëzimet e nevojshme për kreditimin e fondeve në llogarinë e jashtme dhe do t'i konfirmojë me faks Bankës Vepruese në Shqipëri shumën totale të përdorur dhe valutën e kredituar.

7.9. Njëkohësisht me kreditimin në llogarinë e jashtme, Banka Vepruese italiane do të kryejë pagesat për eksportuesit italianë, sipas udhëzimeve të dhëna, të cilët do të bëjnë lëshimin e një dëftese çliruese, sipas shtojcës F në dy origjinale, ku njëri do t'i dërgohet Bankës Vepruese në Shqipëri dhe tjetri MCC-së.

7.10. Pas çdo kreditimi fondesh në llogarinë e jashtme dhe pagesash korresponduese ndaj eksportuesve të lartpërmendur, MCC do t'i transmetojë me shkrim Huamarrësit, Bankës Vepruese në Shqipëri dhe për dijeni Bankës Vepruese italiane, planin e shlyerjes së shumës së përdorur,

bashkë me paraqitjen e afateve përkatëse të skadencës, siç parashikohet në nenin 8 vijues. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin e këtij plani shlyerjeje.

Neni 8

Shlyerja e kredisë financiare dhe pagesa e interesave

8.1. Çdo shumë e kredituar në llogarinë e jashtme do të shlyhet mbi bazën e një plani shlyerjeje në 42 (dyzet e dy) kuota semestrave të njëjta dhe të njëpasnjëshme (të quajtura në vijim “Kuota kapitale”), nga të cilat, e para skadon 210 (dyqind e dhjetë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje financiare. MCC do t’i përcjellë grafikun e shlyerjes, Huamarrësit, Bankës Vepruese në Shqipëri dhe Bankës Vepruese italiane për dijeni, siç është parashikuar në nenin 7.8.

8.2. Mbi kuotat kapitale, efektivisht të kredituara dhe ekzistuese, do të llogariten interesat vjetore, në masën 0.10% (zero presje dhjetë për qind), të barasvlefshme me 0.05% (zero presje zero pesë për qind) e gjashtëmujorit pasues, duke filluar nga data e kreditimit deri në datën e shlyerjes së kuotës kapitale të fundit. Interesat do të llogariten mbi bazën e muajit me tridhjetë ditë dhe të vitit me treqind e gjashtëdhjetë ditë (360/360).

8.3. Gjatë periudhës së shlyerjes, këto interesa do të paguhen në të njëjtat data skadence të kuotave kapitale. Gjatë periudhës “Grace” (mospagim interesash, shënim i përkthyesit), këto interesa do të paguhen sipas semestrave në datat korresponduese në ditë dhe muaj, me datat e pagesave të kuotave kapitale. Në këtë mënyrë, kuota e parë e interesave mund të ketë të bëjë me një periudhë më të vogël se një semestër. Megjithatë nëse një periudhë e tillë rezulton më e vogël se 30 (tridhjetë ditë) kuota përkatëse e interesit do të paguhet së bashku me kuotën pasardhëse të interesit. Kuota e parë e interesit, që ka lidhje me një periudhë më të madhe ose më të vogël se semestri, do të llogaritet për ditët që kanë kaluar, efektivisht, midis datës së kreditimit në llogarinë e jashtme dhe datës së pagesës së saj, mbi bazën e një semestri me 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë.

8.4. Deri në datën e lëshimit të deklaratës së borxhit, sipas nenit 9, pagesa e interesave, në lidhje me çdo përdorim, do të kryhet në datat e skadencës të parashikuara në planin e shlyerjes, sipas nenit 7.8. Pas kësaj date, shlyerja e kapitalit dhe pagesa e interesave do të kryhet në datat e skadencave të parashikuara në planin e shlyerjes, të riprodhuar në deklaratën e lartpërmendur të borxhit.

8.5. Për të gjitha ripagesat dhe për pagesat e tjera të mundshme, që janë detyrime, në bazë të kësaj Marrëveshjeje financiare dhe të deklaratës përkatëse të borxhit, Banka Vepruese në Shqipëri, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, detyrohet të bëjë në kohë, kreditimin e vlerës përkatëse në euro, në favor të MCC-së ose të përfituesve sipas ligjit pranë Bankës Vepruese italiane. Këto vlera do të kreditohen pa zbritur ndonjë komision bankar dhe/ose valutor dhe fiskal dhe pa qenë nevoja për paralajmërim nga ana e MCC-së ose të përfituesve sipas ligjit.

Neni 9

Lëshimi i deklaratës së borxhit

9.1. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga afati i fundit i përdorimit të kredisë, i parashikuar në nenin paraardhës 4.1, Huamarrësi do t’i lëshojë MCC-së, deklaratën e borxhit, të nënshkruar rregullisht e të sigluar në çdo faqe, të hartuar në përputhje me shtojcën E.

9.2. Kjo deklaratë borxhi, është lirisht e transferueshme nga MCC-ja te një person juridik publik, privat italian ose i huaj. Kuptohet, se Huamarrësit nuk mund t’i debitohen detyrime për shpenzime, komisione, taksa ose tatime që rrjedhin nga lëshimi i mundshëm i deklaratës së borxhit. MCC do t’i njoftojë Bankës Vepruese italiane, transferimin e bërë të deklaratës së borxhit.

9.3. Planin e shlyerjes, i risjellë në deklaratën e borxhit, do të hartohet, duke mbledhur kuotat kapitale dhe interesat ende të paskaduara dhe këstet e mundshme të skaduara e të papaguara në datën e lëshimit të deklaratës së borxhit, të rezultuara nga secili plan shlyerje të vendosur kundrejt çdo përdorimi fondi, siç është e parashikuar në nenin 7.8.

9.4. MCC-ja do ta depozitojë deklaratën e borxhit, për ruajtje dhe administrim, pranë Bankës Vepruese italiane, pas vënies së xhiros për çdo arkëtim në favor të saj.

9.5. Banka Vepruese italiane do të evidentojë herë pas here në deklaratën e borxhit, pagesat e kryera të shumave për kapital dhe interesa dhe këstet e mundshme të skaduara e të papaguara. Menjëherë, sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e parashikuara në deklaratën e borxhit, Banka Vepruese italiane, do të marrë masa t'i kthejë Huamarrësit deklaratën e borxhit në fjalë me kuitancë të rregullt.

Neni 10

Detyrimet e Huamarrësit

10.1. Angazhimi i Huamarrësit, për kryerjen e pagesës së shumave të detyrueshme, në bazë të Marrëveshjes financiare dhe të deklaratës së borxhit të lidhur me të është, i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i pakthyeshëm.

Neni 11

Rastet e ndërprerjes së përdorimit

11.1. MCC, gjatë periudhës së përdorimit të kredisë financiare, ruan të drejtën e pezullimit të shpërndarjes, duke mos i dhënë rrugë kërkesave për kreditim, sipas nenit 6, nëse rezultojnë parregullsi ndaj MCC-së sipas kësaj Marrëveshjeje financiare ose ndaj kredive të tjera financiare të dhëna nga MCC-ja për Këshillin e Ministrave, Bankën e Shqipërisë ose ente të tjera shtetërore të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 6 të ligjit italian nr.38, të datës 9 shkurt 1979, dhe nenit 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987 dhe ndryshimeve të mëtejshme. MCC do t'i komunikojë menjëherë pezullimin Huamarrësit dhe Bankës Vepruese në Shqipëri.

11.2. Në rastin kur Banka Vepruese italiane has një pengesë, që për motive të pavarura nga vullneti i saj, nuk i hapin rrugë dhënies së udhëzimeve të kreditimit nga ana e MCC-së në llogarinë e jashtme, siç parashikohet në nenin 7.6, vetë Banka Vepruese italiane do të njoftojë menjëherë me shkrim Huamarrësin, Bankën Vepruese në Shqipëri dhe vetë MCC-në. Pas largimit të shkakut, që ka penguar pagesat të përfuturit përkatës, Banka Vepruese italiane, pas marrjes së mendimit të MCC-së, do t'i japë rrugë, dhënies së udhëzimeve për kreditimet e marra fillimisht, nga vetë MCC-ja.

11.3. MCC ruan të drejtën e mosdhënies rrugë të kërkesave për kreditim, siç parashikohet në nenin 6.4, në rast se nuk i janë vënë në dispozicion shumat përkatëse nga ana e autoriteteve kompetente italiane.

Neni 12

Kamatëvonesat

12.1. Në rast se, për çfarëdo arsye, edhe të pavaruar nga vullneti i Huamarrësit dhe Bankës Vepruese në Shqipëri, shumat detyrim për kapitalin dhe/ose interesat nuk do të mbërrijnë në Bankën Vepruese italiane, brenda datës së përcaktuar të skadencës, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë mbi këto shuma, kamatëvonesat për periudhën, që ka kaluar midis datës së skadencës dhe datës së kreditimit efektiv në favor të MCC-së ose të përfutuesve sipas ligjit, pranë Bankës Vepruese italiane në fjalë.

12.2. Këto kamatëvonesat do të përlllogariten në një masë prej 0,10% (zero presje dhjetë për qind) për 35 (tridhjetë e pesë) ditët pasrendëse nga data fillestare e skadencës, dhe më tej, në masën 2,6% (dy presje gjashtë për qind) deri në vlerën e pagesës efektive për MCC-në. Kjo normë e fundit e kamatëvonesës, do të përditësohet nga autoritetet kompetente italiane, dhe përditësimi i parë do të fillojë nga 1 janar 2007 dhe do të përlllogaritet në përputhje me ecurinë e tregut.

12.3. Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët pasardhëse të datës së fillimit të skadencës, kamatëvonesat do të përlllogaritet gjithmonë me mënyrën e interesit të thjeshtë. Për periudhën e mëtejshme, kamatëvonesat do të llogaritet me mënyrën e interesit të thjeshtë, në rastin kur kjo periudhë është më e vogël se një vit, dhe më mënyrën e interesit të përbërë nga viti në vit, në rastet kur kjo periudhë është më e madhe se një vit.

Neni 13
Rimbursimi i kuotave të mundshme të financimit në rast mosrealizimi të projekteve/programeve

13.1. Në rast mosrealizimi ose realizimi të pjesshëm të projekteve/programeve, Huamarrësi detyrohet, për të ripaguar kuotat e mundshme të dhëna, qoftë edhe vetëm në cilësinë e parapagesës, sipas kushteve të përcaktuara midis MCC-së dhe autoriteteve kompetente italiane.

Neni 14
Detyrime fiskale

14.1. Duke iu përmbajtur asaj çfarë parashikohet në nenin pararendës 9.2 çdo detyrim fiskal i tanishëm ose i ardhshëm, me çfarëdo cilësimi në Shqipëri do t'i ngarkohet ekskluzivisht Huamarrësit, në varësi të Marrëveshjes financiare në fjalë dhe deklaratës përkatëse të borxhit.

14.2. Çdo detyrim fiskal i pagueshem në Itali, nuk do të jetë në ngarkim të Huamarrësit, në varësi të kësaj Marrëveshjeje financiare.

14.3. MCC deklaron, se do të mbështetet në regjimin fiskal, sipas nenit 19 të DPR-së, nr.601, të datës 29 shtator 1973 dhe ndryshimeve të bëra më pas.

Neni 15
Ligji i zbatueshëm

15.1. Kjo Marrëveshje financiare rregullohet sipas ligjit italian.

Neni 16
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të mundshme

16.1. Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo lloj mosmarrëveshje, që rrjedh nga interpretimi dhe/ose ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje financiare.

16.2. Në qoftë se përpjekje të tilla nuk çojnë, brenda një kohe të arsyeshme, në një zgjidhje të mosmarrëveshjeve, atëherë ato mund të zgjidhen në nivel qeveritar.

16.3. Në rast se një përpjekje e tillë, nuk do të ndërmerrej ose (edhe nëse ndërmerrej) nuk do të mund të çonte në një zgjidhje të kënaqshme, të gjitha mosmarrëveshjet, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje financiare ose në lidhje me të, do të zgjidhen në mënyrë përfundimtare, sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Parisit, Francë, nga një Kolegj Arbitrazhi i përbërë nga tre anëtarë:

- njëri i caktuar nga Huamarrësi;
- njëri i caktuar nga MCC-ja;
- njëri i caktuar nga arbitrat e lartpërmendur, ose në rast të mosrënies dakord mes tyre, nga Presidenti i Dhomës Tregtare Ndërkombëtare të Parisit.

16.4. Kur Huamarrësi ose MCC nuk kanë caktuar arbitrin e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e kërkesës së palës tjetër, atëherë arbitri do të caktohet nga Presidenti i Dhomës Tregtare Ndërkombëtare të Parisit.

16.5. Vendimi i Kolegjit të Arbitrazhit, i cili do të gjykojë sipas ligjit italian, do të jetë përfundimtar dhe do të angazhojë palët pa kushte e pa asnjë mundësi ankimi.

16.6. Çfarëdolloj mosrënie dakord ose mosmarrëveshje e lindur mes palëve, gjithsesi nuk mund të pezullojë detyrimin e Huamarrësit, për të paguar sipas afateve përkatëse të skadencës, të gjitha shumat detyrim, sipas kësaj Marrëveshjeje financiare, dhe veçanërisht të gjitha shumat, që rrjedhin nga planet e shlyerjes, siç parashikohet në nenin 8 të mësipërm, si dhe nga deklarata e mëposhtme e borxhit.

Neni 17
Komunikimet

17.1. Çdo komunikim që do të kryhet, në lidhje me këtë Marrëveshje financiare, duhet të bëhet në adresat që vijojnë:

- **MINISTRIA E FINANCAVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”- Tiranë-Shqipëri;

- **BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË:** Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit-6 Tiranë-Shqipëri;

- **MCC S.p.A - Via PIEMONTE 51, 00187 ROMA- ITALI;**

- **PROJECT & EXPORT FINANCE – Istruttoria CONVENZIONI FINANZIARIE:**

Tel. 0039-06-4791-2592/ 2749/2218/2200, TELEFAX N.0039-06-4791 - 2574/2970;

- **SERVIZIO AMMINISTRAZIONE FINANZIAMENTI STRUTTURATI:**

TEL.0039-06-4791-2380/ 2249/2516/2206, TELEFAX N.0039-06-4791 -

2059/ 2758;

N.TELEFAX 626496/626497 - N.SWIFT MCENITRR

- San Paolo IMI: Via Firenze 8/10 Roma

Tel 06 69 022 720 Fax 06 69 022 723 SWIFT: IBSPITTM450

Neni 18
Origjinalet e Marrëveshjes financiare

18.1. Kjo Marrëveshje financiare është hartuar dhe nënshkruar në tre ekzemplarë origjinalë në gjuhën italiane dhe tre ekzemplarë origjinal në gjuhën angleze, ku në rast mospërputhjeje, do të marrë përparësi teksti i hartuar në gjuhën italiane.

Këshilli i Ministrave
i Republikës së Shqipërisë

MCC S.p. A

Firmosur në Tiranë, më

Firmosur në Romë, më.....

Formulari i mandatimit për Bankën Vepruese italiane

Shtojca A

Nga:..... (Huamarrësi)

Për:..... (Bankën Vepruese italiane)

Për:..... MCC-në (për dijeni)

Marrëveshje financiare për..... (.....) euro, e nënshkruar nga ne,
në..... më..... dhe nga MCC në..... më.....

Në lidhje me Marrëveshjen financiare në fjalë, Ju emërojmë me anë të kësaj letre, Bankën tonë Vepruese në Itali.

Për këtë arsye, duhet të çelni një llogari të jashtme në emrin tonë, në të cilën do të kreditohen fondet, që MCC-ja do të vendosë kohë pas kohe në dispozicionin tonë.

Fondet e kredituara nga MCC në llogarinë e jashtme, do të përdoren njëkohësisht sipas udhëzimeve, që do t’ju japë Banka Vepruese në Shqipëri, me anë të një letre të veçantë të përpiluar sipas shtojcës C të Marrëveshjes financiare në fjalë, ekskluzivisht për pagesën e.....

Ju lutemi të na konfirmoni përmes një letre ose me faks, e menjëherë më pas me letër, neve dhe MCC-së, pranimin Tuaj të këtij mandati.

Formulari i kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve

Shtojca B

Nga..... (Banka Vepruese në Shqipëri)
Për: MCC
Marrëveshje financiare për.....(.....) euro, e nënshkruar nga.....,
në..... më..... dhe nga MCC në..... më.....

Sipas nenit 6 të Marrëveshjes financiare në fjalë, Ju kërkojmë të na vini në dispozicion për kreditime të mëtejshme në llogarinë e jashtme, të çelur në emër të Huamarrësit, pranë degës së Romës të....., shumën prej..... (.....) euro (shumë kontraktuale e mbuluar nga kjo kredi).

Ju sqarojmë se kjo shumë i korrespondon pagesave, që i ka detyrim Huamarrësi për..... sipas kontratës tregtare nr....., datë.....ndërmjet..... dhe.....lidhur me.....(Projektet/programet), financueshmërinë dhe rregullshmërinë e së cilave ne Jua konfirmojmë.

Me qëllimin, për të lehtësuar pagesat në favor të....., ne kemi udhëzuar degën e Romës së..... t'ju kërkojë kohë pas kohe, akreditimin në llogarinë e jashtme të fondeve të nevojshme, për kryerjen e pagesave të parashikuara në kontratën tregtare, sipas kushteve dhe mënyrave të specifikuar aty.

Me anë të kësaj letre, Ju konfirmojmë se Huamarrësi, në emër të të cilit ne veprojmë, angazhohet pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme të shlyejë çdo shumë të kredituar nga ju në llogarinë e jashtme, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Marrëveshjen financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga afati i fundit për përdorimin e kredisë financiare, parashikuar në nenin 4 të Marrëveshjes financiare në fjalë, ne angazhohemi t'ju lëshojmë një deklaratë borxhi për shumën principale, të barabartë me shumën e të gjitha shumave të përdorura, sipas kësaj Marrëveshjeje financiare.

Kjo deklaratë borxhi do të hartohet në përputhje me shtojcën E të Marrëveshjes financiare në fjalë.

Formulari i letrës së udhëzimeve për Bankën Vepruese italiane

Shtojca C

Nga..... (Banka Vepruese në Shqipëri)
Për:..... (Bankën Vepruese italiane)
Për:..... MCC (për dijeni)
Marrëveshje financiare për..... (.....) euro, e nënshkruar nga ne
në..... më..... dhe nga MCC, në..... më.....

Sipas nenit 6 të Marrëveshjes financiare dhe në vijim të letrës sonë të datës....., me anë të së cilës ne ju kemi emëruar si Bankën tonë Vepruese në Itali, Ju kemi bashkëngjitur, (të cilën do t'jua paraqesë ndërmarrja italiane përfituese) një kopje të kontratës tregtare nr..... datë..... ndërmjet..... dhe..... lidhur me..... (Projektet/ programet), për të cilën ju deklarojmë, se kemi njohuri të plotë.

Me anë të kësaj letre, ju udhëzojmë, në cilësinë e Bankës sonë Vepruese në Itali, për kryerjen e të gjitha pagesave të parashikuara në kontratën e furnizimit në fjalë, sipas kushteve dhe mënyrave të specifikuar aty, në favor të..... deri në shumën maksimale prej..... (.....) euro (shumë kontraktuale e mbuluar nga kjo kredi).

Pagesat që do të kryeni do të varen nga paraqitja prej eksportuesit/esve italianë, të dokumentacionit kontraktual (si: faturat, bill of lading, packing list, situacione punimesh etj.) dhe nga lëshimi po prej tij/tyre i një dokumenti marrjeje çlirues në dy origjinalë.

Në lidhje me këtë, do t'i dorëzoni një kopje MCC-së, në përputhje me dokumentacionin kontraktual të lartpërmendur dhe një origjinal të dokumentit çlirues të marrjes, duke na e përcjellë ne origjinalin e dokumentacionit kontraktual së bashku me origjinalin e dytë të dokumentit çlirues të marrjes.

Gjithashtu, ju udhëzojmë t'i kërkonti drejtpërdrejt MCC-së, herë pas here, kreditimin në llogarinë e jashtme, të fondeve të nevojshme, për kryerjen e pagesave të parashikuara në këtë kontratë furnizimi, sipas kushteve dhe mënyrave të specifikuara në të (çdo kërkesë duhet të na transmetohet për dijëni, me faks ose me swift).

Ju bëjmë të ditur se për këtë qëllim, i kemi kërkuar MCC-së kreditimin e herëpashershme në llogarinë e jashtme, sipas kërkesës suaj, të fondeve të nevojshme, për kryerjen e pagesave në favor të..... për llogarinë tonë.

Ju lutemi të na konfirmoni me letër ose faks, i cili do të konfirmohet menjëherë më pas me letër ne dhe MCC-në, pranimin nga ana Juaj të këtyre udhëzimeve.

LIGJ

Nr. 9343, datë 10.2.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8770, DATË 19.4.2001 "PËR SHËRBIMIN E RUAJTJES DHE TË SIGURISË FIZIKE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 2 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

"2. Licenca jepet pasi shoqëria të jetë regjistruar në regjistrin tregtar dhe të ketë të përcaktuar në aktin e themelimit drejtuesin teknik. Ajo jepet me afat trevjeçar, me të drejtë përtëritjeje, kur nuk kanë ndryshuar kushtet e dhënies së saj."

Neni 2

Shkronja "d" e pikës 1 të nenit 14 ndryshohet si më poshtë:

"d) është me moshë nën 65 vjeç."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4496, datë 28.2.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr. 9344, datë 17.2.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES USHTARAKE GRANT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË TURQISË”**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4497, datë 28.2.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJA
USHTARAKE GRANT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë,
duke riarfirmuar dhe një herë marrëdhëniet e tyre të gjata miqësore,
duke iu referuar marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e trajnimit ushtarak, teknikës dhe shkencës, datë 29.7.1992 dhe marrëveshjes së bashkëpunimit dhe trajnimit ushtarak të datës 19.11.1992, dhe

për qëllimin e forcimit të bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Turqisë do t'i dhurojë 1 960 000 000 000 (një trilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë bilionë) lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, Qeverisë së Republikës të Shqipërisë. Granti do të jetë i disponueshëm nga viti 2004.

Neni 2

Granti prej 1 960 000 000 000 (një trilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë bilion) lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të sigurohet si materiale dhe shërbime, në përputhje me rregullat në fuqi të Republikës së Turqisë.

Neni 3

Granti prej 1 960 000 000 000 (një trilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë bilionë) lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të realizohet në përputhje me protokollin e zbatimit logjistik, i cili do të nënshkruhet ndërmjet zyrtarëve të të dyja palëve të referuara në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord të mos transferojë titujt, materialet/shërbimet një vendi ose pale tjetër, pa marrë më parë miratimin e Republikës së Turqisë, e cila ka dhënë këtë grant.

Neni 5

Marrëveshja do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga palët lidhur me përfundimin e të gjithave procedurave të brendshme për ratifikim, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe do të jetë në fuqi deri sa të gjitha materialet dhe shërbimet e specifikuar në protokollin zbatues t'i jenë dhënë Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë.

Marrëveshja grant do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe nga Shtabi i Përgjithshëm Turk në emër të Republikës Turke.

Çdo mosmarrëveshje e lidhur gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me diskutime dhe bisedime të dyanshme.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në shqip, anglisht dhe turqisht. Në rast të mosmarrëveshjeje lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti anglisht i Marrëveshjes do të jetë prioritar.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar, më 8 shtator 2004, Ankara, Turqi.

NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË SHQIPËRISË
Jonuz Begaj
AMBASADOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
ANKARA/TURQI

NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË TURQISË
Ali Akdogan
GJENERAL BRIGADE
SHEF I SEKTORIT TË
MENAXHIMIT TË BURIMEVE
DHE PLANIFIKIMIT TË MBROJTJES
NË SHTABIN E PËRGJITHSHËM

LIGJ

Nr. 9345, datë 17.2.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË POLONISË PËR MBROJTJEN E PËRBASHKËT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR”

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Polonisë për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4498, datë 28.2.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË POLONISË MBI MBROJTJEN E PËRBASHKËT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Polonisë, më poshtë referuar si Palët Kontraktuese, duke pasur si qëllim mbrojtjen reciproke të të gjithë informacionit që është klasifikuar sipas ligjit të brendshëm të njërës Palë Kontraktuese dhe transferuar palës tjetër kontraktuese nga autoritetet kompetente ose persona të autorizuar, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1. Informacioni i klasifikuar, për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, është çdo informacion i cili, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit këtu, gjithashtu edhe gjatë përgatitjes, kërkon mbrojtjen ndaj zbulimit të paautorizuar.

2. Dokumentet të cilat përmbajnë informacione referuar në paragrafin 1, do të markohen me nivelet e klasifikimit të sigurisë sipas ligjeve të brendshme të çdo Pale Kontraktuese. Palët Kontraktuese do të markojnë dokumentet që përmbajnë informacione referuar në paragrafin 1, me nivelin ekuivalent të klasifikimit të sigurisë, sipas dispozitave të paragrafit 3.

3. Palët Kontraktuese pranojnë që nivelet e klasifikimit të sigurisë dhe ekuivalentet e tyre të jenë si më poshtë:

Republika e Shqipërisë	Republika e Polonisë	Ekuivalenti anglisht
TEPËR SEKRET	SCISLE TAJNE	TOPSECRET
SEKRET	TAJNE	SECRET
KONFIDENCIAL	POUFNE	CONFIDENTIAL
KONFIDENCIAL	ZASTRZEZONE	RESTRICTED/CONFIDENTIAL

Neni 2

Autoritetet kompetente

1. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente do të jenë:
 - Për Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurimit Kombëtar).
 - Për Republikën e Polonisë: Drejtuesi i Agjencisë së Sigurimit të Brendshëm (për fushën civile) dhe Drejtuesi i Shërbimeve Informative Ushtarake (për fushën ushtarake).
2. Autoritetet kompetente mund të konkludojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Masat e ndërmarra nga Palët Kontraktuese

1. Në përputhje me këtë Marrëveshje dhe ligjet e brendshme, Palët Kontraktuese do të ndërmarrin masat e duhura me qëllim mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, i cili transmetohet ose prodhohet si rezultat i bashkëpunimit reciprok të të dyja Palëve Kontraktuese.

2. Palët Kontraktuese do të sigurojnë për informacionin referuar në paragrafin 1 të paktën të njëjtën mbrojtje siç aplikohet për informacionin e tyre të klasifikuar, në nivelin përkatës të klasifikimit të sigurisë, sipas nenit 1 paragrafi 3.

3. Informacioni i klasifikuar i transmetuar do të shfrytëzohet vetëm në përputhje me qëllimin për të cilin ai është transmetuar.

4. Çdo Palë Kontraktuese nuk do t'i japë ndonjë pale të tretë informacionin e paraqitur në paragrafin 1, pa pëlqimin më parë të autoritetit të Palës tjetër Kontraktuese.

5. Informacioni i klasifikuar i transmetuar do të lejohet vetëm për ata persona që kanë nevojë për njohje dhe që janë certifikuar dhe brifuar sipas ligjeve të brendshme të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 4

Kontratat që përfshijnë aksesin në informacionin e klasifikuar

1. Një subjekt që lejon zbatimin e një kontrate (pala kryesore) mund ta përfundojë kontratën me një subjekt që është për zbatimin e kontratës (kontraktori) së caktuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në qoftë se zbatimi i kontratës ka lidhje me dhënien e informacionit të klasifikuar kontraktorit nga ana e kontraktorit apo atij që prodhon këtë informacion të klasifikuar gjatë zbatimit të kontratës.

2. Në rastin e referuar në paragrafin 1, kontraktuesi do t'i kërkojë autoritetit kompetent, për ta paraqitur tek autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese, nxjerrjen e një garancie me shkrim se kontraktori autorizohet të ketë akses në informacionin e klasifikuar për nivelin e caktuar të klasifikimit të sigurisë.

3. Nxjerrja e garancisë, referuar në paragrafin 2, do të jetë njëlloj me garancinë e drejtimit të veprimeve të nevojshme për të vërtetuar se kontraktori i plotëson kriteret e duhura për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, ashtu siç përcaktohet në ligjin e brendshëm të shtetit në territorin e të cilit ndodhet kontraktori.

4. Në qoftë se kontraktori nuk është autorizuar më parë të ketë akses në informacionin e klasifikuar për nivelin e caktuar të klasifikimit të sigurisë, autoriteti kompetent i cili do të nxjerrë garancinë, do të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese se, me kërkesën e tij, veprimet e referuara në paragrafin 1 mund të bëhen.

5. Pala kryesore do të njoftojë kontraktorin për kërkesat e sigurisë së domosdoshme për të zbatuar kontratën, e cila përfshin në veçanti një listë të informacionit të klasifikuar dhe rregullat e klasifikimit të informacionit që prodhohet gjatë zbatimit të kontratës. Kërkesat e sigurisë do të paraqiten nga autoritetet kompetente.

6. Autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës kryhet kontrata, do të sigurojë se kontraktori e mbron informacionin e klasifikuar transmetuar nga pala kryesore ose prodhuar gjatë kryerjes së kontratës në përputhje me kërkesat e sigurisë referuar në paragrafin 5 dhe ligjet e brendshme të Palës së interesuar Kontraktuese.

7. Kryerja e kontratës në pjesën që lidhet me aksesin në informacionin e klasifikuar do të lejohet kur kontraktori plotëson kriteret e domosdoshme për mbrojtjen e këtij informacioni të klasifikuar.

8. Autoritetet kompetente do të sigurojnë që çdo nënkontraktor i mundshëm të jetë i detyruar të plotësojë të njëjtat kushte për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, ashtu siç ato përcaktohen për kontraktorin.

Neni 5

Markimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar i transmetuar do të markohet me nivelin korrespondues të klasifikimit të sigurisë sipas nenit 1 paragrafi 3.

2. Kërkesa referuar në paragrafin 1 do të zbatohet gjithashtu për informacionin e klasifikuar që prodhohet nga kontaktori gjatë kryerjes së kontratës që përfshin aksesin në informacionin e klasifikuar.

3. Kopjet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të marrë do të markohen dhe mbahen në të njëjtën mënyrë si origjinalet.

4. Niveli i klasifikimit të sigurisë do të ndryshohet ose lëvizet me kërkesën e autoritetit të Palës tjetër Kontraktuese, i cili ka përcaktuar nivelin e klasifikimit të sigurisë. Autoriteti i cili ka përcaktuar nivelin e klasifikimit të sigurisë do të njoftojë menjëherë autoritetin e Palës tjetër Kontraktuese për ndonjë ndryshim apo lëvizje të nivelit të klasifikimit të sigurisë.

Neni 6

Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar do të transmetohet nga korrierë diplomatikë sipas paragrafëve 2 dhe 3. I adresuari do të konfirmojë marrjen e informacionit të klasifikuar dhe do ta transmetojë atë në përputhje me ligjin e tij të brendshëm.

2. Në raste të veçanta, autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese mund të miratojnë një procedurë tjetër për transmetimin e informacionit të klasifikuar, e cila do të sigurojë mbrojtjen e tij ndaj zbulimit të paautorizuar.

3. Informacioni i klasifikuar mund të transmetohet nëpërmjet sistemeve dhe rrjeteve të mbrojtura të telekomunikacionit, të cilat janë certifikuar sipas ligjit të brendshëm të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 7

Vizitat

1. Personat që vijnë për vizitë nga njëra Palë Kontraktuese te Pala tjetër Kontraktuese do të lejohen të kenë akses në informacionin e klasifikuar në të gjithë hapësirën e nevojshme, si dhe në ambientet ku mbahet informacioni i klasifikuar, vetëm pas marrjes së lejes me shkrim nga autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese.

2. Leja referuar në paragrafin 1 do të jepet vetëm për personat e autorizuar të kenë akses në informacionin e klasifikuar sipas ligjit të brendshëm të Palës Kontraktuese që delegon këta persona.

3. Të dhënat personale të personave që vijnë për vizitë te Pala tjetër Kontraktuese, deri në nivelin që kërkhet për të siguruar lejen referuar në paragrafin 1, do t'i transmetohen më parë autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese.

4. Autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për hollësitë e një aplikimi për vizitë dhe do të sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 8

Shkelja e rregullave të sigurisë që lidhen me mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar

1. Në rast se autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese identifikon një zbulim të paautorizuar të informacionit të klasifikuar të Palës tjetër Kontraktuese, ky autoritet kompetent do të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Shkelja e rregullave të sigurisë, që lidhen me mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, do të investigohet dhe ndiqet sipas ligjit të brendshëm të Palës Kontraktuese, në

territorin e së cilës ka ndodhur kjo shkelje.

3. Autoriteti kompetent i njërës Palë Kontraktuese do të informojë menjëherë autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese mbi rezultatet e veprimeve referuar në paragrafin 2.

Neni 9 **Shpenzimet**

Secila Palë Kontraktuese do të mbulojë shpenzimet e veta që rezultojnë nga zbatimimi i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10 **Konsultimet**

1. Autoritetet Kompetente të Palës Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për ndonjë amendament të rregulloreve që lidhen me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, ashtu siç ato parashtrihen në ligjet e tyre të brendshme përkatëse.

2. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të këshillojnë njëri-tjetrin, me kërkesën e njërit prej tyre, në mënyrë që të sigurojnë bashkëpunim të ngushtë në zbatimin e dispozitave.

3. Secila Palë Kontraktuese do të lejojë përfaqësuesit e autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese që të vijnë për vizitë në territorin e tyre për të diskutuar procedurat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të transmetuar nga Pala tjetër Kontraktuese.

Neni 11 **Dispozitat e fundit**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit në vazhdim, pas marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit Palës Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se kërkesat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

2. Kjo Marrëveshje është konkluduar për një periudhë kohore të pacaktuar. Ajo mund të përfundohet nga njëra Palë Kontraktuese me dhënien e njoftimit Palës tjetër Kontraktuese. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të mbarojë pas gjashtë muajve me marrjen e njoftimit të përfundimit.

3. Në rastin e përfundimit, çdo informacion i klasifikuar i transmetuar ose i prodhuar si rezultat i bashkëpunimit të përbashkët do të vazhdojë të mbrohet sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje për aq kohë sa nevojitet sipas nivelit të klasifikimit të sigurisë.

4. Çdo paqartësi lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të sqarohet nga negociatat ndërmjet Palës Kontraktuese.

Bërë në Tiranë më 21 shtator 2004, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip, polonisht dhe anglisht, të gjitha tekstet janë plotësisht të njëjta. Në rast të mospërputhjeve të interpretimit, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

LIGJ **Nr. 9346, datë 17.2.2005**

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7973, DATË 26.7.1995 “PËR KONCESIONET DHE PJESËMARRJEN E SEKTORIT PRIVAT NË SHËRBIMET PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11. Në shërbime të caktuara në administratën publike, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në paragrafin e parë të nenit 4, pas fjalëve “në pikat 2, 3, 4, 7, 8, 9 dhe 10” shtohet pika “11”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4499, datë 28.2.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

UDHËZIM

Nr. 1, datë 14.12.2004

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 6.2.2003 “PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 10.11.1998 “PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit

UDHËZOJNË:

1. Në udhëzimin nr.1, datë 6.2.2003 “Për disa shtesa në udhëzimin nr.1, datë 10.11.1998 “Për përdorimin e të ardhurave”, në pikën 2 në fund të paragrafit të parë, pas fjalëve: “.....gjatë veprimtarisë për vlerësimin cilësor të markave të cigareve të pranishme në tregun shqiptar...”, të shtohen fjalët:

“dhe dhënien e lejes së përpunimit industrial dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI I BUJQËSISË DHE
USHQIMIT
Agron Duka

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

UDHËZIM
Nr. 1, datë 14.12.2004

**PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË TARIFËS PËR DHËNIEN E LEJES SË
PËRPUNIMIT INDUSTRIAL DHE/OSE PRODHIMIT TË PRODUKTEVE TË DUHANIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 14 të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.126, datë 27.2.2003 “Për kriteret e dhënies së lejes së përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit”, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

I. Me përpunim industrial të duhanit kuptojmë procesin e përpunimit të duhanit gjeth si produkt të gatshëm për industrinë e prodhimit të produkteve të duhanit. Procesi i përpunimit industrial të duhanit përfshin:

- Klasifikimin e duhaneve të grumbulluara nga fermeri;
- Manipulimin e duhaneve në tonga;
- Ambalazhimin dhe etiketimin e tongave;
- Fermentimin e duhaneve.

II. Pas përfundimit të këtij procesi, duhanet e përpunuara janë të gatshme për t’u përdorur për prodhimin e produkteve të duhanit, që janë: cigaret, purretat, purot, duhanet për llullë, duhani kaush, burnoti dhe duhani për përtpypje.

III. Personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që kryejnë ose kërkojnë të kryejnë përpunimin industrial të duhanit dhe/ose prodhimin e produkteve të tij, duhet të bëjnë kërkesë me shkrim pranë Agjencisë Kombëtare të Duhani-Cigareve për t’u pajisur me leje të përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit. Leja është e vlefshme për 10 vjet dhe pajisja me leje bëhet pasi të shlyhet tarifa përkatëse.

IV. Kriteret për caktimin e tarifës për dhënie e lejes së përpunimit industrial të duhanit janë:

1. Kapaciteti grumbullues dhe përpunues i duhaneve;
2. Niveli teknologjik i instaluar dhe i shfrytëzuar:

- I mekanizuar quhet procesi ku i gjithë përpunimi, që nga shfletosja dhe klasifikimi e deri te manipulimi, realizohet nëpërmjet mjeteve të mekanizuara, si: transportierë, sistemi pneumatik, harmonizues dhe sitë vibruese për realizimin e shfletosjes, si dhe sistemit të presimit për manipulimin e duhaneve në tonga.

- Gjysmë i mekanizuar është procesi i kombinuar me dorë dhe me mjete të mekanizuara, ku me dorë kryhet shfletosja dhe deklasifikimi i duhaneve, kurse manipulimi i duhaneve në tonga kryhet nëpërmjet sistemit të mekanizuar të presimit.

a) Për subjektet që kanë nivel teknologjik të mekanizuar dhe kapacitet grumbullues dhe përpunues të duhaneve:

- deri në 1000 ton/vit, tarifa është	290 000 lekë
- deri në 2000 ton/vit, tarifa është	350 000 lekë
- mbi 2000 ton në vit, tarifa është	410 000 lekë.

b) Për subjektet që kanë nivel teknologjik gjysmë të mekanizuar dhe kapacitet grumbullues dhe përpunues të duhaneve:

- deri në 1000 ton/vit, tarifa është	230 000 lekë
- deri në 2000 ton/vit, tarifa është	290 000 lekë

- mbi 2000 ton në vit, tarifa është 350 000 lekë.

V. Kriteret për caktimin e tarifës për dhënien e lejes së prodhimit të produkteve të duhanit janë:

1. Kapaciteti prodhues i produkteve të duhanit;

2. Teknologjia e prodhimit e instaluar:

- Proces i plotë i prodhimit, ku përfshihen proceset e harmonizimit, konfeksionimit, ambalazhimit.

- Procese të konfeksionim-ambalazhimit.

a) Për subjektet që kanë proces të plotë prodhimi dhe kapacitet prodhues të produkteve të duhanit:

- deri në 300 ton produkte duhani në vit, tarifa është	350 000 lekë
- deri në 600 ton produkte duhani në vit, tarifa është	410 000 lekë
- mbi 600 ton produkte duhani në vit, tarifa është	460 000 lekë.

b) Për subjektet që kanë procese të konfeksionim-ambalazhimit me kapacitet prodhues të produkteve të duhanit:

- deri në 300 ton produkte duhani në vit, tarifa është	240 000 lekë
- deri në 600 ton produkte duhani në vit, tarifa është	300 000 lekë
- mbi 600 ton produkte duhani në vit, tarifa është	350 000 lekë.

VI. Sipas përcaktimit të bërë nga komisioni i ekspertëve, subjektet do të shlyejnë tarifën e përcaktuar në pikat IV.a, IV.b dhe V.a, V.b të këtij udhëzimi.

VII. Administrimi i të ardhurave të krijuara nga veprimtaria për dhënien e lejes së përpunimit industrial dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi është edhe tabela bashkëlidhur mbi përcaktimin e tarifave.

IX. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE I USHQIMIT
Agron Duka

**PËRCAKTIMI I PAGESAVE TË ANËTARËVE TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT DHE TARIFAVE PËR DHËNIEN E LEJES SË PËRPUNIMIT INDUSTRIAL
DHE/OSE PRODHIMIT TË PRODUKTEVE TË DUHANIT**

Nr.	Emërtimi	600			602			Kosto	Fitimi 10%	Tarifa
		Paga	Dieta	Shp.transp	Shp.Përgj					
I.	Kriteret për caktimin e tarifës për dhënie e lejes së përpunimit industrial të duhanit janë:									
I.a	Për subjektet që kanë nivel teknologjik të mekanizuar dhe kapacitet grumbullues dhe përpunues të duhaneve									
	Deri 1000 ton/vit	110 000	100 000	10 000	44 000	264 000	26 400	290 000		
	Deri 2000 ton/vit	132 000	120 000	12 000	52 800	316 800	31 680	350 000		
	Mbi 2000 ton/vit	154 000	140 000	14 000	61 600	369 600	36 960	410 000		
I.b	Për subjektet që kanë nivel teknologjik gjysëm të mekanizuar dhe kapacitet grumbullues dhe përpunues të duhaneve									
	Deri 1000 ton/vit	88 000	80 000	8000	35 200	211 200	21 120	230 000		
	Deri 2000 ton/vit	110 000	100 000	10 000	44 000	264 000	26 400	290 000		
	Mbi 2000 ton/vit	132 000	120 000	12 000	52 800	316 800	31 680	350 000		
II.	Kriteret për caktimin e tarifës për dhënie e lejes së prodhimit të produkteve të duhanit janë:									
II.a	Për subjektet që kanë proces të plotë prodhimi dhe kapacitet prodhues të produkteve të duhanit:									
	Deri 300 ton/vit	132 000	120 000	12 000	52 800	316 800	31 680	350 000		
	Deri 600 ton/vit	154 000	140 000	14 000	61 600	369 600	36 960	410 000		
	Mbi 600 ton/vit	176 000	160 000	16 000	70 400	422 400	42 240	460 000		
II.b	Për subjektet që kanë procese të konfeksionim-ambalazhimit me kapacitet prodhues të produkteve të duhanit:									
	Deri 300 ton/vit	88 000	80 000	8000	35 200	211 200	21 120	240 000		
	Deri 600 ton/vit	110 000	100 000	10 000	44 000	264 000	26 400	300 000		
	Mbi 600 ton/vit	132 000	120 000	12 000	52 800	316 800	31 680	350 000		

VENDIM
Nr. 9, datë 9.3.2005

PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2005
PËR OPERATORËT E LICENCUAR

Në zbatim të neneve 9 dhe 12 pika 1, 3, 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2005, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Administrimit, Financës dhe Burimeve Njerëzore, Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve, si dhe Departamenti i Licencimit dhe i Monitorimit, për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2005 për operatorët e licencuar,

VENDOSI:

1. Pagesat e rregullimit për operatorët e licencuar për vitin 2005 të jenë sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit, Financës dhe Burimeve Njerëzore të njoftojë të licencuarit për shumën e detyrimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

TABELA E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2005
PËR OPERATORËT E LICENCUAR

Nr.	Kompania	Pagesat e Rregullimit (lekë)
1.	ESSEGEI sh.p.k.	55 000
2.	HYDROELECTRIC COMPANY OF ALBANIA sh.p.k	73 000
3.	EMIKEL sh.p.k.	39 000
4.	AMAL sh.p.k.	7 000
5.	SPAHIU-GJANC sh.p.k.	57 000
6.	WONDER-POWER sh.a.	51 000
7.	SARMIER sh.p.k.	4 000
8.	SAROLLI sh.p.k.	1 000
9.	JUANA sh.p.k.	1 000
10.	WTS energji sh.p.k.	1 000
11.	MARJAKAJ sh.p.k.	1 000
12.	KORSEL sh.p.k.	3 000
13.	GSA sh.p.k.	10 000
14.	DARDANIA sh.p.k.	1 000
15.	KESH sh.a.	41 863 000
	Shuma për ERE	42 167 000

VENDIM
Nr. 14, datë 11.3.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
NGA SHOQËRIA “SPAHIU – GJANÇ” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa b, dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.3.2005, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SPAHIU-GJANÇ” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Gjanç dhe relacionin e përgatitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos,

VENDOSI :

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “SPAHIU- GJANÇ” sh.p.k., për HEC-in Gjanç, për periudhën 1.1.2005-31.12.2005, të jetë 5,9 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria “SPAHIU-GJANÇ” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 15, datë 11.3.2005

**PËR KOMPENSIMIN E KONSUMATORËVE NDAJ TË CILËVE NUK JANË ZBATUAR
VENDIMET E ERE-S PËR VLERAT E FATURIMIT AFORFE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 3, germa b, ç dhe g, 9 dhe 26 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.3.2005, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënive me Publikun, për inspektimin e kryer në lidhje me zbatimin e vendimeve të ERE-s për vlerat e faturimit aforfe në konsumatorët familjarë, pa aparat matës ose me matës jashtë kushtit teknik,

KONSTATON:

KESH sh.a. ka shkelur në mënyrë të përsëritur vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.12, datë 29.10.2002 “Për vlerat e faturimit aforfe për konsumatorët familjarë që nuk kanë aparat matës” për periudhën e dimrit 1 tetor 2003–31 mars 2004 dhe nr.23, datë 30.4.2004 “Për miratimin e sasisë së energjisë elektrike të përlllogaritur për t’u faturuar aforfe për abonentët familjarë pa matës ose me matës jashtë kushtit teknik” për periudhën 1 prill 2004–30 shtator 2004, si dhe nenin 6 të kontratës për furnizimin me energji elektrike për konsumatorët të kategorisë familjarë.

VENDOSI :

1. KESH sh.a., për konsumatorët ndaj të cilëve nuk janë respektuar vlerat e faturimit aforfe të vendosur nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s, të bëjë kompensimin në sasi dhe vlerë të energjisë elektrike, në faturat e muajve pasardhës deri në likuidimin e plotë të kësaj vlere.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare .

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 322, datë 7.3.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV CALVIN”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.311, datë 28.1.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.022/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike subjektin “Calvin Vizion” sh.a. për televizionin “TV Calvin”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendimi hyn në fuqi në datën 9.11.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr. 323, datë 7.3.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “NESËR TV”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.023/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, subjektin “Teknomedia” sh.p.k. për televizionin “Nesër TV”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendimi hyn në fuqi në datën 9.11.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr. 324, datë 7.3.2005

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR PRIVAT
“RADIO RUSVELT”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Halil Lalaj	Kryetar
Albert Minga	zv/kryetar
Sefedin Çela	anëtar
Lazër Stani	anëtar
Visar Zhiti	anëtar
Agim Duro	anëtar
Fatos Lulo	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit “Radio Rusvelt”,

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr.314, datë 28.1.2005 i KKRT-së “Për shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit radiofonik vendor “Radio Rusvelt”,

VËREN SE:

Me vendimin nr.62, datë 19.10.2001 të KKRT-së është licencuar si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh subjekti fizik z.Gëzim Shehu, për “Radio Rusvelt” me numër licence 034/FML. Ky vendim ka hyrë në fuqi në datën 15.1.2002.

Lidhur me përfundimin e afatit të licencës, KKRT-ja ka njoftuar subjektin, duke i bërë të ditur dhe realizimin e detyrimeve për rinovimin e licencës në bazë të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së.

Pas depozitimit të dokumentacionit përkatës nga subjekti “Radio Rusvelt”, Komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit përgatit aktet përkatëse, të cilat i paraqiten për shqyrtim Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit.

Me vendimin nr.314, datë 28.1.2005 “Për shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit radiofonik vendor “Radio Rusvelt”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit vendosi të mos i rinovojë licencën subjektit “Radio Rusvelt”, pasi kishte këto mangësi:

- Të dhënat teknike të transmetuesit;
- Lista e aparaturave dhe pajisjeve që përdoren për prodhimin e programeve;
- Diagrama në planin horizontal dhe vertikal e antenës, parashikimi i mbulimit të zonës së licencimit;
- Specifikimet e antenave transmetuese;
- Të dhënat për kapitalin sipas kriterëve të përcaktuara;
- Garancia bankare në shumën 10% të kapitalit.

Sipas pikës 1 të këtij vendimi, subjekti kishte të drejtë që, brenda një afati prej 15 ditësh, të bënte plotësimet e nevojshme.

Për sa më sipër, subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion sipas pikës 1 të vendimit nr.314, datë 28.1.2005 “Për shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit radiofonik vendor “Radio Rusvelt”.

Në mbështetje të nenit 56/a të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit “Palët e interesuara duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative nëpërmjet të cilave merren vendime në lidhje me pretendimet e tyre”, është njoftuar subjekti me shkresën nr.185 prot., datë 28.2.2005, por ai nuk u paraqit.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, neni 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 314, datë 28.1.2005 të KKRT-së “Për shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit radiofonik vendor “Radio Rusvelt”,

VENDOSI:

1. Nuk rinovohet licenca e subjektit radiofonik vendor “Radio Rusvelt”.
2. Licenca nr. 034/FML bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti “Radio Rusvelt” është i detyruar të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM **Nr. 326, datë 7.3.2005**

PËR HEQJEN E LICENCËS SË TELEVISIONIT KABLLOR “CNA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Halil Lalaj	Kryetar
Albert Minga	zëvendëskryetar
Sefedin Çela	anëtar
Lazer Stani	anëtar
Visar Zhiti	anëtar
Agim Duro	anëtar
Fatos Lulo	anëtar

mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit “TV CAN”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5, neni 124 dhe neni 34 pika 4/a të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr.300, datë 22.12.2004 i KKRT-së “Mbi vlefshmërinë e licencës së televizionit kabllor “CNA”.

Me vendimin nr.300, datë 22.12.2004 “Mbi vlefshmërinë e licencës së “TV CNA”, këtij subjekti i është lënë një afat prej 15 ditësh, për të dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë vendim.

Brenda afatit të mësipërm, si dhe pas komunikimit me telefon me administratorin e shoqërisë, z.Dritan Çelaj, subjekti “TV CAN” nuk ka paraqitur asnjë pretendim përpara Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit.

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOJ DHE I TELEVISIONIT,

pasi dëgjoji relatorët e çështjes, znj.Argita Shkupi, Andrea Nathanailli dhe znj.Ermira Mushi, subjekti në mungesë,

VËREN SE:

Me vendimin nr.144, datë 27.6.2003 të KKRT-së është licencuar si operator televiziv kabllor privat në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll për një periudhë prej 6 vjetësh, shoqëria “Cable Network Albania” sh.p.k., për televizionin “CAN” me nr.licence 009/RTVK. Ky vendim ka hyrë në fuqi në datën 17.7.2003.

Në zbatim të urdhrin nr.31, datë 7.4.2004 të kryetarit të KKRT-së “Për inspektimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, në muajt prill-maj u krye inspektimi mbi të gjitha subjektet radiotelevizive kabllore të licencuara i përcaktuar në urdhrin e mësipërm. Ndaj subjektit “TV CAN” nuk u krye inspektim, pasi nuk kishte dalë në transmetim.

Me shkresën nr.829, datë 26.8.2004, u është kërkuar nga ana e Departamentit të Programeve të gjitha subjekteve radiotelevizive kabllore të licencuara, ndërmjet të cilëve edhe “TV CAN”, të depozitojnë deri në datën 30 shtator 2004 listën e të gjitha kanaleve tokësore apo satelitore, programet e të cilave ritransmetojnë.

Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën nr.797/1, datë 31.8.2004, administratori i shoqërisë, z. Dritan Çelaj, konfirmon se televizioni kabllor “CAN” nuk ka filluar ende transmetimin.

KKRT-ja vëren se, në bazë të nenit 34 pika 4/a të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, KKRT ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit, kur subjekti nuk ka filluar transmetimin pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe prej 270 ditësh.

KKRT-ja vëren, gjithashtu, se nga ana e subjektit janë shlyer detyrimet financiare për vitin 2003, në shumën totale 1 050 000 lekë, nga të cilat:

- Pagesa vjetore e licencës, në shumën prej 1 000 000 lekë;
- Pagesa për marrjen e licencës, në shumën prej 50 000 lekë.

Për vitin 2004, subjekti ka një detyrim financiar prej 1 000 000 lekësh për pagesën vjetore për licencë. Lidhur me këtë, është njoftuar me shkresën nr.156, datë 11.2.2004 ku përcaktohet dhe afati i shlyerjes, brenda 3-mujorit të parë të vitit 2004.

Në mbështetje të nenit 137/3 “Për t’i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen e licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi”, është njoftuar subjekti me shkresën nr.64, datë 24.1.2005 e më pas me shkresën nr.185 prot., datë 28.2.2005.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5, nenit 34 pika 4/a dhe nenit 124 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të KKRT-së nr.300, datë 22.12.2004 “Mbi vlefshmërinë e licencës së “TV CNA”,

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën shoqërisë “Cable Network Albania” sh.p.k., për televizionin kabllor privat “TV CNA”.
2. Licenca nr.009/RTVK bëhet e pavlefshme.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën “Për shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve preken nga projekti për instalimin e dritave të uljes në aeroportin “Nënë Tereza”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është aeroporti “Nënë Tereza” sh.a.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU DURRES

Lista e pronarëve që preken nga projekti i realizuar për instalimin e Dritave të Uljes
se Aeroportit " Nene Tereza "

Lloji i pasurise se paluajtshme: toke are

Nr	Emer	Atesia	Mbiemri	Nr. pas.	Toke are			Shenime
					Sip. m2	Cmimi l/m2	Vlera leke	
1	Asllan	Hamdi	Kodra	161/5	792	1164	921888	konfirmim nga Z.Rr.P.P
2	Falbardh	Ymer	Ahmeti	161/4	428	1164	498192	konfirmim nga Z.Rr.P.P
3	Basri		Mane	121/2	10830	1164	12606120	konfirmim nga Z.Rr.P.P
4	Basri		Mane	118/1	1340	1164	1559760	konfirmim nga Z.Rr.P.P
5	ANTA			160	1375	1164	1600500	konfirmim nga Z.Rr.P.P
Shuma					14765		17186460	

Shenim : Brenda afatit ligjor 15 dite pas publikimit, te gjithë pronarët qe jane me shenime konfirmim nga Z.Rr.P.P., te paraqesin . dokumentacionin e nevojshem ligjor (certifikate, harte treguese e karte) te noterizuara, prane sektorit te shpronësimeve ne ne Ministrine e Transportit dhe Telekomunikacionit.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurisë së paluajtshme të tipit “Shtëpi banimi”, e cila rrezikohet nga linja e tensionit të lartë 400 kv Elbasan-Kufi.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është KESH sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E INDUSTRIËS DHE ENERGJETIKËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË VENDNDODHJES SË BANESËS SË TYRE BRENDA ZONËS MBROJTËSE TË “LINJËS TË TENSIONIT TË LARTË 400 KV ELBASAN-KUFI”.

RRETHI : LIBRAZH
FSHATI : VULÇAN

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: **Shtëpi Banimi.**

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurisë që shpronësohet	Zona Kadastrale	Numri i Pasurisë	Sasia ne m2	Cmimi ne leke/m2	Vlera e Kompesimit ne leke.	Adresa
1.	RESHIT	ARIF	STAFJA	Shtëpi Banimi	3843	407/1	96	15.000	1.440.000	Vulçan- Librazhd
/	TOTALI								1.440.000	

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 25.3.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë